



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE- OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 96/23

Nr. i fq. / Br. si -1-

Data: / Datum 13.04.2023

VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

### Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **27 prill 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 mars 2023;
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave "Uniteti" për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit "Mitrovica" për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023;
6. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**



*Melihate Basholli-Latifi*  
Kryesuesë e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUČITRN

<b>PËR:</b>	<b>Kuvendin e komunës</b>
<b>NGA:</b>	<b>Melihate Basholli Latifi</b> <i>Melihate Basholli Latifi</i> <b>Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë</b>
<b>TEMA:</b>	<b>Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 12.4.2023</b>

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **12 prill 2023** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të përgatitet materiali dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2022.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica” për vitin 2022.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*
4. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023.  
*Për këtë pikë të rendit të ditës:  
Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -III- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË**  
**VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 30 MARS 2023**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:*

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi:** Gresa Muli.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-paraqiti para kuvendit pika e dërguara në të ndryshme për ti inkorporuar në rendin e ditës.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –pyeti kryetarin e komunën lidhur me pasjen me leje ndërtimore të një objekti që ndodhet tek Ura e Gurit konkretisht sipër maketit “Korabi Show” që evidentohet në emër të z. Ilmi Azemi. Lidhur me këtë ai vlerësoi se dikur kishte deklaruar që është mirë që ky vendim të merret dhe mos të bllokohet personi në fjalë ndoshta për arsye të uljes politike që ka pasur tendencë ti bëhet këtij personi. Në këtë kontekst kërkoi të sqarohet opinion publik se çka ndikoj në lëshimin e këtij vendim a mos ndoshta fakti i publikimi të dështimeve që ky person i publikuar në vazhdimësi për anëtarët e qeverisë komunale. Nëse ka qenë qëllimi për ta ulur politikisht z. Ilmi Azem atëherë atij duhet ti kërkohet falje. Po ashtu pyeti kryetarin e komunës se përse nuk e përfill vendimin e kuvendit lidhur me shkollën e vjetër objektin e shkollës “Migjeni” në Stanoc të Epërm.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit** – tha se nuk ka të bëj asgjë me çështjen që e ngriti parafolësi i tij dhe atë në cilësinë e asamblistit. Më tej sqaroi se për kundër divergjencave që mundën me pas PDK në Vushtri vazhdon rrugëtimin e saj unik dhe të fuqishëm.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –ngriti shqetësimin e tij lidhur me kualitetin e dobët të pllakave të vendosura në shtëpitë që kanë shërbyer si shkolla, në vitet e nëntëdhjeta, pllaka këto ku janë vendosur mbishkrimet për ti përkujtuar kontributin e atyre familjeve që kanë shërbyer arsimit në vitet më të vështira të okupimit. Kërkoj që këto pllaka në aspekti teknik të përmirësohen. Mandej shtoi se tek Halil Dumnica, ka pasur disa shtëpi që janë përdorur si shkolla dhe këto duhet të evidentohen në vendosjen e këtyre pllakave.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –parashtrij disa pyetje për kryetarin e komunës lidhur me pretendimet për disa blerje private (donacione) në laboratorin e QKMF-së në Vushtri, por që në bazë të faturave të cilat janë ndryshuara disa herë del e kundërta dhe pikërisht për këtë kërkoj të bëhen sqarime, pyetje konsistojnë në: a ka të drejtë drejtori i drejtorisë komunale të jetë pjesë e komisionit të vlerësimit dhe pranimit e një malli aparature për laboratorin e mjekësisë në këtë rast a ka konflikt të interesit? A kishte donacion në laboratorin e QKMF-së? Në qoftë se kishte donacion a është regjistruar në programin e E-pasurisë së komunës dhe QKMF-së nëse vërtet ishin donacion, ashtu siç parashihet me ligj? Nëse janë blerë prej cilit fond janë paguar dhe sa ka qenë çmimi? A ndodhen sot të njëjtat aparatura dhe reagenca në lokalet e QKMF-së? A gjendet sot i njëjti aparat hematologjik në laboratorin e QKMF-së? Nëse nuk gjendet kur ka dal a është regjistruar dhe nëse është dal në cilën procedurë ligjore është evidentuar dalja nga QKMF-ja? A gjendet sot aparati hematologjik i cili figuron në këto fatura në laborator, dhe nëse nuk gjendet me cilën procedurë është liruar nga objekti i laboratorit? Nëse kanë qenë blerje private-donacion pse është dashur të përdoret shablloni i formatit të tabelave i pagesave i Komunës së Vushtrrisë. Në fund pyeti se a është intervistuar dikush në Drejtorinë e Shëndetësi nga ana e organeve të drejtësisë.

**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit** –kërkoj nga kryesuesja e kuvendit që ashtu siç ishte votuar në mbledhjen e kaluar të vendoset në rend të ditës pika pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e kuvendit. Çështjen tjetër që ngrit është shkarkimi nga detyra i anëtarit të komisionit për verifikimin e pronës komunale z. Shkelëzen Xhaferi i cili nuk e ka kryer punën si duhet, për shkak se ai ka penguar punën e komisionit dhe ka luajtur vetëm rolin e informatorit tek strukturat tjera. Kërkoj nga kuvendi që ta liron nga detyra të lartpërmendur dhe ta zëvendësoj me një anëtar tjetër.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –kërkoj sqarime se në raportin i cili është hartuar për shtëpitë-shkolla është paraparë që të gjithë mësuesit që kanë punuar në ato shkolla tu ndahet nga një mirënjohje me datë 7 mars ditën e mësuesit. Kërkoj të di nga kryetari i komunës se a janë ndarë këto mirënjohje.

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit**–përsërit pyetjen e saj lidhur me një raport për angazhimin e një ekspertit juridik në vlerë prej 18,000.00€ i ka kushtuar komunës por që një raport të tillë ajo nuk e ka pranuar akoma.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar kryetari të komunës i cili e kishte cilësuar si të papërgjegjshëm dhe të njëanshëm anëtarin e komisionit të arsimit z.Hashim Hajrizi, në seancën e kaluar i njëjti është propozuar nga kryetari dhe votuar nga kuvendi për të një komision të natyrës së tillë. Mandej paradoksi është se kryetari i komunës emëron Drejtor të DKA-së një njeri nga shoqëria civile ndërsa anëtarët e komisionit për pranim në punë i emëron nga partia, kjo i bie shmangie nga përgjegjësia dhe pranim në punë sipas vijës partiake.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –pyeti kryetarin e komunës se a është në dijeni se është ndal furnizimi me kifile për nxënësit e shkollave të Komunës së Vushtrrisë, dhe cila është arsyeja për në veprim të tillë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit**-përsëriti pyetjen e saj lidhur me parkingjet për personat me nevoja të veçanta, mandej për orarin e shkarkimit të mallrave nëpër maketet e qytetit, pyeti se çfarë veprimesh janë ndërmarr lidhur me këto problematika.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-në adresimin e tij para kuvendit, uroj të gjithë muajin e shenjët të Ramazanit duke iu dëshiruar agjërim të lehtë. Tutje në deklarin e tij ai u përgjigje në pyetjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit duke shtuar se asnjëherë ai nuk tenton dhe nuk është në karakterin e tij të ulë të tjerët. Lidhur me lejen ndërtimore që lidhet me familjen Azemi sqaroi se le të shkon sipas procedurave, ndërsa pala nëse pretendon se iu kanë bërë shkelej atëherë e ka të drejtën juridike të ankesës-padisë. Lidhur me shkollën e fshati Stanoc njoftoi se kuvendi ka votuar për mos vazhdimin e asaj kontrate pasi që ajo veç kishte skaduar. Mos vazhdimi ka të bëjë se prona është e AKP-së ndërsa objekti i komunës por ka pasur edhe devijim nga projekti dhe kontrata. Në këtë rast gabim është bërë nga pushteti i kaluar sepse është dhënë shfrytëzim prona që nuk ka qenë e komunës. Raportin e eksperti juridik do ta sjellë në mbledhjen e radhës. Lidhur me vendosjen e pllakave në shtëpitë-shkolla tha se i ka parë dhe i ka vërejtjet e tij ndërsa e falënderoj komisionin për punën që ka bërë. Për mbledhjen e radhës u zotua se do të raportoj për këtë çështje më në detale. Lidhur me pyetjen për pajisje me reagenca tha se do ta merrni përgjigjen nga drejtori i DSHP-së. Lidhur me shtëpitë-shkolla dhe nëse ka vendim kuvendi për mirënjohës për mësimdhënësit e asaj kohe atëherë ai vendim duhet të zbatohet. Emërimi i drejtorit të DKA-së nuk është peng i asnjë kalkulimi politik e partiak por qëllimi është ngritja e cilësisë në arsim. Lidhur me punën e komisionit të arsimit tha se anëtarët janë vendosur sipas ligjit, por ka pasur gabime nga disa anëtarë të komisionit për punën e të cilëve ai ka vërejtje, kjo për faktin se janë thirrur në një udhëzim administrativ i cili ka qenë i shfuqizuar. Lidhur me mos furnizim me kifile për nxënësit njoftoi se janë dy arsye për mos furnizim e para është planifikimi i cili ka qenë vetëm për tre muaj, ndërsa tjetra mungesa e buxhetit për shkak të rritjes së kostos së furnizimit me këtë artikull. Mandej kualiteti ka qenë jo i duhur dhe kësaj shumica e atyre kifileve kanë përfunduar në shportë të mbeturinave. Lidhu me pretendimin e Qeverisë së Kosovës për marrjen e parave nga të hyrat vetanake tha se ky veprim është antikushtetues dhe antiligjor.

**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHP-së**-duke ju referuar diskutimit të Sylejman Mehollit, për laboratorin në QKMF sqaroi se po të mos ishte ky i fundi ai nuk e di se çfarë do të diskutonte për shëndetësinë, më tej shtoi dhe deklaroi se në fund të vitit 2021 kishte skaduar kontrata për furnizim me material shëndetësor reagenca dhe materiale tjera, ndërsa përgjegjës për inicim procedure për këto furnizime është biokimisti dhe kryelaboranti të cilët kanë pasur për detyrë të sigurojnë furnizim me këto materiale pa ndërprerje si rezultat e këtyre mos furnizimeve ishte ndërprerë puna e laboratorit. Këta persona janë përgjegjës për këto humbej pasi që ata kanë qenë në dijen se një procedurë e prokurimit për këtë çështje zgjatë gati tre muaj dhe kjo neglizhencë duhet të ketë qenë e qëllimshme për të shkaktuar sabotim në punë. Si drejtor kishte kërkuar ndihmë edhe nga spitali në Vushtrri po nuk kishte gjetur zgjidhje, ndërsa një depo i kishte dal në ndihmë në huazimin e aparatit hematologjik ndërsa materialet shpenzuese i kishte siguruar nga kontoja e tij personale dhe kjo mund të dëshmohej edhe me fatura. Ndërsa kur ky material sillet në laborator personat përgjegjës nuk e pranojnë material me pretendimin se nuk dihet prejardhja e këtij materiali. Në këtë kontekst shtoi se ai ka paguar këtë donacion për reganca duke parë gjendjen e rënd të qytetarëve dhe duke i kursyer ata në shpenzimet e tyre për analizat që ata kanë nevojë ti bëjnë. Në fund përfundoj se në shoqërinë tonë më shumë vlerësohen ata që i ka arrestuar policia se sa ata që tentojnë tu dalin në ndihmë qytetarëve.

**Dardan Abazi, drejtor i DKA-së-** deklaroi dhe sqaroi se emërimi i tij si drejtor nuk është pjesë e asnjë koalicioni apo pazari politikë. Nuk ka ndonjë marrëveshje për tu bërë drejtor dhe shtoj se nuk është peng politikë i askujt.

**Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-**njoftoi se 22 vend parkingje janë të rezervuara për peronat me nevoja të veçanta. Ndërsa sqaroi se shumë shpejt do të filloj procesi i shenjzimit të tyre sipas protokollit standard. Lidhur me furnizimet me mallra në makete njoftoi se është nxjerr një urdhëresë e cila shumë shpejt do tu dërgohet bizneseve.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se ndjenë keqardhje për siç tha për gjendjen në të cilën e ka sjellë qeverisja aktuale shëndetësinë e komunës dhe kjo është e tmerrshme janë 77 shërbime laboratorike më pak në vitin 2022 krahasuar me vitin 2022. Më tej ai duke ju referuar faturave për furnizim me materiale shpenzuese laboratorike vazhdoi ta kontestoj se a kemi të bëjmë me faturë donacioni privat apo është pagesë e bërë nga komuna dhe për këto ai u zotua se do ti procedoj tek organet kompetente për ti hetuar.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se argumentet dhe faktet që po i prezanton parafolësi i tij nuk janë të qëndrueshme dhe i vjen keq që në kësi forma tentohet të përbaltes dikush nga qeveria komunale. Nëse drejtori i shëndetësisë i ka paguar nga financat private ato reagenca duke mos pasur tjetra mundësi atëherë ai duhet falënderuar e jo të kritikohet në të kundërtën le të dërgohet tek prokurori “Drejtori i Shëndetësisë dhe le të ia shqiptojnë një dënim pasi që ka dhënë donacion” ky letë bëhet rasti i parë në Kosovë. Pastaj ceku se shkelje ka pasur në qeverisjen e kaluar kur është marr pagë si mësimdhënës i shkollës së mesme ndërsa ka punuar në shkollë fillore.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –lidhur me pagën shtesë që ka marr sqaroi se askush nuk mund ta sjellë atë dhe familjen e tij të pozitë të rënd, sepse edhe nëse kjo është e vërtetë ai nuk bartë asnjë përgjegjësi sepse punëdhënës bënë ekzekutimin e pagesave dhe për shkak të paaftësie së tyre një gjë e tillë ka ndodhur. Tutje shtoi se është e turpshme të tentohet në kësi lloj formash të diskreditohet dikush vetëm pse ka tjetër mendim dhe nuk pajtohet me shkeljet që kanë ndodhur në fushën e shëndetësisë.

**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-**propozoi që lidhur me bartjen e mjeteve financiare vetanake të bëhet shkoqitja apo ndarja e kësaj pike të rendit të ditës në tri pika apo vendime dhe atë pika e parë bartja e mjeteve vetanake të tejkualuar, mandej bartja e mjeteve financiare nga fondi 21 si dhe bartja e mjeteve vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Pika e 6 e rendit të ditës të ndahet në tri pika të veçanta ashtu siç u propozua më lartë.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se fillimisht duhet të merret vendimi për bartjen e mjeteve të tejkualuar, e më pas duhet të merret mendimi i Departamenti të Thesarit se sa mjetet i ka të lira Komuna e Vushtrrisë e mandej të procedohet me aprovimin e vendimeve tjera, në të kundërtën rrezikohet që këto vendim të kthehen si jo ligjore dhe ekziston rreziku që këto mjete ti humb komuna.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin për bartjen e të hyrave vetanake komunale nga viti 2022 në vitin 2023. Në vazhdim ai njoftoj kuvendin se bartja e mjeteve bëhet konform ligjit të buxhetit të Republikës së Kosovës, për ndarjet buxhetore. Po ashtu deklaroi se kuvendi duhet ti votoj këto tri vendim me qëllim që mos të humbi kohë në realizimin e projekteve të cilat janë kontraktuar dhe që të zhvillohen sipas dinamikës së paraparë. Andaj ai bëri thirrje që këto vendi të aprovohen me vota unanime.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:**

## **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 23 shkurt 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022;
3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.2.2020;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2022;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga fondi 21 nga viti 2022 në vitin 2023;
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale;
11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;
12. Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt si rezultat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për Shtetin e Turqisë dhe Sirisë si pasojë e tërmetit;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;
14. Rishqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e Planit Lokal për veprim në Mjedis;
15. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
16. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (**hartimin**) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij.
17. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 23 shkurt 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 23 shkurt 2023.**

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022;

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se vitin 2022 e ka karakterizuar rekordi i shkuarjes së buxhetit në suficit dhe kjo ka ndodhur si rezultat i paaftësisë së qeverisë së z.Idrizi, në këtë kontekst përsërit se në vitin 2022 Komunës së Vushtrisë i kanë shkuar në suficit hiq më pas se 4, 364,487.00 €, në shëndetësi suficit ka shkuar në 794.000.00 € dhe është rekord që nga pas lufta në mos realizimin e buxhetit. Në lëmin e arsimit kanë shkuar në suficit 767,406.00 € ndërsa thuhet se nuk ka para për furnizim me kiflet për nxënësit andaj kjo është paradoksale ku në njërin anë mjetet shkojnë në suficit e në anë tjetër thuhet se ka mungesë të mjeteve për financimin e aktiviteteve shkollore. Më tej kërkoj sqarime tek faqja 21 e raportit tabela e furnizimeve sipas informatave që ka shërbimet e deratizimit deszisektimit dhe dezinfektimit, ku thuhet se për këtë aktivitet lënda ka shkuar në OSHP, andaj pyeti a është e vërtet që dy nga tre ofertuesi që kanë qenë më të lirë janë eliminuar gjoja se iu ka munguar një dokument kjo për ta favorizuar një operator të tretë i cili bazën profesionale e ka veterinarinë, pra shkolla dhe institucionet shëndetësore dezinfektohen me veterinarë ndërsa janë eliminuar kompanitë që kanë epidemiologë e që janë të fushë së ngushtë, për këtë kërkoj sqarime dhe pyeti se a ka dikush lidhshmëri nga Drejtorja e Prokurimit me këto kompanitë e DDD-së. Lidhur me faktin e mbylljes së dy ambulancave sipas tij kërkoj të bëhet e ditur se a është njoftua Ministria e Shëndetësisë për këto veprime.

**Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS**-lidhu me pretendimin për mbylljen e dy ambulancave, njoftoj se askush nuk ka deklaruar se janë mbyllur ato, por se nuk janë funksionale për shkak të mungesës së banorëve-pacientëve. Ndërsa këto shërbime në këto lokalitete ku ka mungesë të pacientëve është duke i kryer Islamic relief.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –duke ju referuar raportit ceku se janë të shqetësuar sepse në vitin 2022 ka shuma të mëdha të mjeteve financiare që kanë shkuar në suficit, andaj kërkoj nga qeveria që në vitin 2023 të jenë më të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave të tyre dhe ngritjen e performancës sa i takon shpenzimit të buxhetit. Tutej ceku se bazuar në të dhënat e raportit del se kemi rënie sa i përket testi të kalueshmërisë për klast e nënta nga 49.78% në vitin 2021 në 44.59% në vitin 2022 pra përqindja e kalueshmërisë në nivel të komunës nuk ka arritur 50%. Duke marr për bazë se në vitin 2021 DKA në Vushtrri nga MAPL ka marrë vetëm 2 pikë nga 10 sa janë të mundshme del se nuk kemi ngritje të cilësisë së arsimit por kemi rënie. Janë tri shkolla që kanë arritur sukses në test Shkolla “Emin Duraku” Novolan 60.45%, shkolla fillore në Nedakoc 58.84\$ dhe shkolla fillore “Mustafë Shyti” në Oshlanë 55.50% gjë të cilën e përshëndesim. Në shkollat e mesme të larta kemi ngritje kalueshmërisë në shkollën “Lutfi Musiqi” nga 31 % në vitin 2021 në 65.04% në vitin 2022, në shkollën e mesme “Bahri Haxha” kemi ngritje të përqindjes së kalueshmërisë nga 48.38 % në vitin 2021 në 72.37 % në vitin 2022, ndërsa në Gjimnazin “Eqrem Çabejë” nga 99% në 99.6%. Në raport konstatohet se kemi rënie të përqindjes së suksesit të shkëlqyeshëm në të tri nivelet e shkollimit klasat I-V për 2.7%, klasat VI-IX 0.73% dhe në klasat X-XII kemi rënie në 3.1% nga vitin 2021 në vitin 2022. Në fakt tjetër është se kemi mos përputhje të numrit të nxënësve mes raport të kryetarit dhe prezantimit që është bërë në informatën e DKA-së, në të parin kemi numrin total prej 13,151.00 nxënës, ndërsa në informatë kemi 12.635 nxënës.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 22 vota “për” 6 vota “kundër” aprovoj Raportin për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2022.**

**3. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023;**



**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit** –shprehu nevojën që të kemi trajnime për mësimdhënësit ashtu që të ngritet aftësi i stafit mësimor dhe po ashtu edhe cilësia në arsim. Mandej shtoj se ka shkollë e cila ka 8 punëtor teknik ndërsa ke edhe me 2 punëtor dhe kjo duhet të analizohet se pse ndodh kështu a kanë mëtej katror të barabartë këto shkolla. Kërkoj të bëhet sistemimi i këtyre punëtorëve arsimor. Pastaj kërkoj të di se përse disa shkolla kanë pedagog e disa tjera jo cilat janë kriteret për një gjë të tillë. Në vazhdim ai njoftoj kuvendi me një projekt-propozim i cili i ishte drejtuar DKA-së por e cila fare nuk ishte marr me këtë çështje, projekt kishte të bënte me përmirësimin e gjendje infrastrukturore shkollore. Më tej ai ngrit shqetësimin e tij për dëmtimin e infrastrukturës në shkollën fillore në Stanoc të Poshtëm, ku kërkoj që të kemi një intervenim të shpejt për ta përmirësuar, e po ashtu ka nevojë edhe për një aneks objekt, kjo për faktin se kemi rritje të numrit të nxënësve.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit** –ceku se ka pasaktësi sa i përket prezantimit të dhënave për fillimin e viti shkollor 2022-2023 t cilat duhet të përmirësohen. Në informatë nuk ceket se kur ka përfunduar gjysmëvjetori i parë i viti shkollor 2023. Mandej në informatë nuk është prezantuar asnjë e dhënë sa i takon testit të maturës. Ajo çka e ka karakterizuar DKA në këtë gjysmë-vjetor është dorëheqja e drejtoreshës së DKA-së dhe mbetja për më tepër se 60 ditë pa drejtor e këtij dikasteri. Anulimi dhe përsëritja e konkurseve për stafin arsimor, mungesa e mësimdhënësve e si pasoj humbja e shumë orëve mësimore dhe humbjet në mësim nxënie. Në shumë shkolla mungesa e aparateve fotokopjuese dhe materialit shpenzues e në disa shkolla edhe mungesa e ujit të pijes. Mungesa e lëndëve djegës në të gjitha shkollat gjatë periudhës së dimrit, mungesa e kabinetëve, laboratorëve, mjeteve dhe veglave si dhe substancave kime për realizimin e praktikës profesionale. Mos implementimi i kontratës kolektive nga DKA dhe Komuna e Vushtrrisë ku përfshihen shujtat për mësimdhënësit, pagat përcjellëse, udhëtimi licenca që janë përgjegjësi e komunës. Mungesa e transportit për nxënësit e shkollave teknike, profesionale për realizimin e praktikës profesionale në ndërmarrje e fabrika siç parashihet me planin mësimor. Në informatë konstatohet se kemi numër të madh të mungesave në të tri nivelet e shkollave, andaj duhet ndërmarr veprim për përmirësimin e kësaj gjendje. Po ashtu kemi rënie të numrit të suksesit të shkëlqyeshëm dhe dallim i madh nga shkolla fillore në atë të mesme të ulët dhe të mesme të larët në këtë gjysmëvjetor. Një tjetër sfidë mjaft e madhe është përdorimi i madh i telefonave nga nxënësit sidomos gjatë orëve mësimore. Në fund pyeti se si do të veprohet me disa shkolla në viset rurale ku është zvogëluar numri i nxënësve, ndërsa shihet se kemi rritje për këtë vit të numrit të punëtorëve për 21 punëtor më shumë andaj si do të bëhet pagesa e këtyre punëtorëve.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit** –tha se i gjithë fokusi i kryetarit të komunës dhe i kësaj qeverie në fushën e arsimit është tek konkurset duke punësuar njerëz politikisht që i shërbejnë dhe militant partiak. Mandej si mund ti ofrosh kësaj qeverie ekspertizën kur këta mendojnë vetëm për punësim. Në raport thuhet se janë blerë 20 çanta për nxënës në shkollën në Zhilivodë, ndërsa atje kemi vetëm 7 nxënës, kujt i janë dërguar ato çanta. Tutje shtoi se në vitet e fundit ka ndryshuar në mënyrë radikale qasja ndaj jetë në përgjithësi e po ashtu edhe raporti nxënës-mësues në veçanti kjo për shkak të gravitimit të madh të teknikës dhe teknologjisë, kësaj ndodhemi para një sfide mjaft të rëndësishme më të cilën vërtet është dashur të merremi shumë seriozisht. Pastaj apeloj dhe kërkoj nga udhëheqësi e arsimit të evidentohen shkollat që punojnë me nga 10 nxënës ato me ma pak se 50 nxënës apo me ma pak se 100 nxënës dhe planifikojeni në dy apo tri vitet e ardhshme se si do të vjen puna, sepse edukimi është aspekt multi dimensional dhe në këto shkolla ku ka më pak se 10 nxënës nuk mund të flitet për edukim.

**Zojë Hajrizi, anëtare e kuvendit**-pasi i përshëndeti të pranishmit tha se se pari dua t'ju uroj muajin e shenjte te Ramazanit, të gjithë ju që agjëroni, ju uroj agjërim te lehte, dhe vepra të

pranuara. Tutje shtoi se në baze të informatave që i ka marrë nga Drejtoria e Arsimit, numri i nxënësve nga klasa 1-5 është 5077, dhe për këtë nivel dua të bëjë një kërkesë Drejtorisë se Arsimit, që të kemi një projekt ku do ti furnizojmë shkollat me dollapë për ruajtjen e librave të fëmijëve nga klasa e 1-5, mendon që është mese e nevojshme pasi që kemi dëgjuar ankesa nga fëmijët për peshën e rendë që e bartin nëpër çantat e tyre, e po ashtu, shqetësime ka pasur edhe nga prindërit për peshën e rendë që kanë çantat e fëmijëve të cilët mund të kenë edhe probleme shëndetësore. Të fillojmë me furnizimin e dollapëve me këtë nivel, e pastaj vazhdojmë edhe me nivelin 2 dhe 3. Kërkesa ime e radhës është që Drejtoria e Arsimit, të fillojë me programe të veçanta të edukimit shëndetësor, që të organizoj vizita sistematike dhe informuese mjekësore, duke filluar nga çerdhet e deri te shkollat e mesme. Mendon që është më se e nevojshme që fëmijëve t’ju mbajmë sesione informuese për edukimin shëndetësor.

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –vlerësoi se edhe përkundër faktit se në tri vitet e fundit arsimit është goditur rënd nga pandemia, prapëseprapë duhet përgëzuar nxënësit dhe mësimdhënësit për fitoret që kanë korrur në gara të ndryshme. Lidhur me humbjet e orëve kërkoj nga DKA që bëjnë një planifikim të saktë dhe të mirë lidhur me pensionimin e mësimdhënësve dhe të shpallë konkurset me kohë që mos të humbet mësimi. Lidhur me konkurset dhe procedurat e rekrutimit në arsim tërhiqi vërejtjen për ti lanë me një anë shkeljet që po ndodhin në mënyrë recidiviste, dhe ti kthemi politikave të mirëfillta arsimore dhe zhvillimit të kuadrove që i nevojiten vërtetë arsimit në komunën tonë. Lidhur me shkollat me nxënës pak tha se duhet të ulen të gjithë bashkë si qeveri dhe si kuvend, ndoshta me një komision të përbashkët nga pozita dhe opozita për ta gjetur një zgjidhje oportune e cila vërtetë na shërben si qytetar dhe si komunë. Në fund tha se duhet pasur një strategji komunale për ta përmirësuar gjendjen në arsim, dhe vlerëson se duhet të tejkalohet mënyra klasike e ligjërimit dhe transmetimit të mësimit duke kaluar në metoda bashkëkohore.

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesues e Kuvendit**-tha se është e nevojshme të kemi një strategji për ta përmirësuar gjendjen në arsim, dhe njoftoj se disa shkolla të komunës ka korrur sukses dhe fitore edhe në garat republikane dhe kjo është një e arritur. Ajo shprehu nevojën të kemi platformën e-shkollori, që kjo duhet të aplikohet sepse e bënë më të lehtë të përcillen mësimet dhe aktivitetet tjera.

**Dardan Abazi, drejtor i DKA-së-paraqiti** sqarime lidhur me informatën për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2022/2023, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarë e kuvendit. Ai vlerësoi se është sfidë e madhe migrimi dhe rënia rapide e numrit të nxënësve në viset rurale të komunës. Pastaj shtoi se është duke punuar të ketë një sistemim të punëtorëve teknik sipas nevojave që shfaqen në teren.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se të gjithë ju duhet ta dini problematikën e zbatimit të kontratës kolektive, kjo për faktin se subjekt të marrëveshje janë sindikata dhe MASHT-i, komuna nuk është palë, prandaj në ligjin e buxhetit, nuk ka kod për realizimin e këtyre pagesave. Mësimdhënësit e dinë që këto mjete i kanë realizuar përmes përmbaruesit dhe tani nuk është korrekte të kërkohej se përse komuna nuk i realizon këto pagesa. Në bazë të vullnetit të mirë është munduar si kryetar i komunës të gjejë një ujdi për ti shmangu procedurat e përmbarimore dhe shpenzimet shtesë po kjo ka dështuar tani ata i kërkojnë këto borxhe nga e kaluar në rrugë gjyqësore. Tutje shtoj se ka konflikt mes ligjeve të arsimit atij për arsimin parauniversitar dhe Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës si dhe udhëzimit administrativë për numrin e nxënësve. Kjo sepse me Ligjin për arsimin parauniversitar shkollim fillor dhe të mesë të ulët e bënë obligativë, ndërsa udhëzimi administrativë qetë kritere tjera përcakton kriterin nxënës-mësimdhënës ku raporti është 1 mësimdhënës me 21 nxënës e që sipas këtij kriteri i bie që duhet mbyllë shumicën e shkollave në viset rurale, për shkak të mungesë së nxënësve (rënies së numrit).

Në këtë konstalacion, komunat kanë një sfidë mjaftë të madhe duke mos ditur se si të veprohet. Lidhur me aftësimin profesional njoftoi se 11 profile profesionale në Qendrën Gjermane të Trajnimeve janë të paguara për arsimin për të rritur për të ritë dhe të rejtat që dëshirojnë me u përgatitë për tregun e punës, ky është koncepti i tij i zhvillimi të arsimit. Është investuar për ngritjen e bursave për studentë, në trajnime të buta dhe si rezultat i kësaj janë punësuar disa të rinj me pagë jashtëzakonisht konkurrues për tregun e Kosovës. Ai njoftoi kuvendin se është duke punuar jashtëzakonisht fort në zhvillimin e praktikës profesionale që nxënësit 60% të kohës ta kalojnë në ndërmarrjeje ashtu që të zhvillohen profesionalisht.

**4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë;**

**Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit**-njoftoi se për aprovimin e kësaj pike nevojiten 2/3 e anëtarëve të kuvendit dhe votimi duhet të bëhet në formë të fshehtë.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit**-lidhur me këtë pikët të rendit të ditës, pyeti kryetarin e komunës se a është ky vendimi i njëjtë për të cilin para disa seancave keni deklaruar se ky vendim ekziston në kuadër të buxhetit të komunës dhe i njëjti nuk ka nevojë të votohet. Po ashtu a jeni në dijeni se ky vendim është kthyer si kundërligjshme dy herë radhazi dhe dyshon se prapë i njëjti do të anulohet. Sa i përket LDK-së ajo asnjëherë nuk ka qenë kundër ndërtimit të lapidareve, por jo në procedura të kundërligjshme.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha edhe tani e edhe atëherë qëndron prapa deklaratave të tij se ky vendim është aprovuar në kuadër të buxhetit, dhe caktimi i lokacionit do të duhej të bëhet me shumicën e thjesht të votave të kuvendit. Po vlerësimi i MAPL-së ka qenë tjetër dhe tani duhet respektuar vendimi i tyre.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –paraqiti një ekspozitë lidhur me figurën e heroit <Adem Voca> i cili ka qenë dhe mbetet një figurë e lavdishme e historisë sonë, i cili ka rezistuar kundër forcave armike okupatore serbo madhe. Tutej shtoi se ndërtimi i këtij lapidari është më e pakta që mund të bëhet për këtë figurë kombëtare, andaj ftoj të gjithë pa dallim ngjyrim politik ta përkrahin dhe votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

Në vazhdim kuvendi me vota unanime themeloi komisioni për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e procesit të votimit lidhur me pikën e rendit të ditës propozim-vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë, në përbërjen si në vijim:

**Nurie Halili, anëtare e kuvendit PDK;**  
**Bujar Pllana, anëtar i kuvendit LDK;**  
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit LVV.**

Në vazhdim Ymer Hardinaj, anëtar i komisionit konstatoj se i ka pranuar 35 fletëvotime të vulosura në gjendje të rregull dhe filloj procesin e votimit të fshehtë.

**Pas përfundimit të procesit të votimit të fshehtë Ymer Haradinja konstatoj se në votim kanë marrë pjesë gjithsejtë 31 anëtar të kuvendit, prej tyre 19 vota janë “për”, 12 vota janë “kundër” nuk ka abstenime, me çka konstatoj se kjo pikë e rendit të ditës nuk ka arritur koten prej 2/3 të votave që nevojiten për aprovim (kjo pikë e rendit të ditës nuk aprovohet).**

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** –shprehu indinjatën e thellë për mos aprovimin e pikës së rendit të ditës për lapidarin për heroin “Adem Voca”, ku ceku se një hije të rënd turpi i kemi qitur qytetit ata të cilët nuk e votuan apo e votuan kundër. Për sakrificën e tij tashmë është e tepër të flitet sepse ai ka sakrifikuar krejt familjen e tij për brezat e ardhshëm, ndërsa ne vërtet të votojmë kundër është e turpshme dhe do ti mbuloj turpi të gjitha ata që votuan kundër.

**5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me nr. 01.49/20 i datës 27.2.2020;**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim korrigjohet pika 1.1 dhe 1.2 e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit 01 nr.49/20 i datës 27.2.2020 për dhënien në shfrytëzim me kompensim të vendgjuetive të përbashkëta, ashtu që bëhet korrigjimi i sipërfaqes si në vijim:**

- 1.1. Shalë .....19,485.00 ha
- 1.2. Çyqavica.....12,878.67 ha

**2. Pjesët tjera të vendimit me numër të protokollit 01.nr.49/20 i datës 27.2.2020 mbesin në fuqi.**

**3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: harta për zonën e Shalës dhe zonën e Çyqavicës.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja për Prokurim dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**

**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit shpërndarjen e të hyrave vetanake të tejkaluara për buxhetin e vitit 2022;**

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi se duke u bazuar në legjislacionin në fuqi është bërë një tejkalim i të hyrave vetanake për buxhetin e vitit 2022 shuma totale e këtyre mjeteve është 716,419.94 €, në kategoritë ekonomike sipas sistemit të menaxhimit të financave publike.**

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerët abstenim vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet shpërndarja e tejkalimit të planit të të hyrave vetanake për vitin 2022, në kategoritë ekonomike si në vijim:**

- 1.1. Paga dhe mëditje .....10,000.00 €
- 1.2. Mallra dhe shërbime .....499,095.51 €
- 1.3. Shpenzime komunale.....3,511.39 €

1.4. Subvencione dhe transfere.....	50,000.00 €
1.5. Investime kapitale.....	153,813.04 €
<b>Totali i mjeteve të bartura.....</b>	<b>716,419.94 €</b>
<b>2. Paga dhe Meditje</b>	
2.1. Zyra e Kuvendit Komunal.....	10,000.00 €
<b>3. Në kategorinë Mallrat dhe shërbime</b>	
3.1. Zyra e kryetarit (16024).....	30,000.00 €
3.2. Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425).....	65,015.51 €
3.3. Infrastruktura publike (18184).....	126.080.00 €
3.4. Menaxhimi i fatkeqësive natyrore, (18468).....	50,000.00 €
3.5. Administrata (92120).....	208,000.00 €
<b>4. Në kategorinë Shpenzime komunale</b>	
4.1. Infrastruktura publike (18184).....	3,511.39 €
<b>5. Në kategorinë e Subvencionet dhe Transferet</b>	
5.1. Zyra e kryetarit (16024).....	40,000.00 €
5.2. Administrata (73033).....	10,000.00 €
<b>6. Në kategorinë e shpenzimeve kapitale</b>	
6.1. Instrastruktura publike(18184), në projektet:	
Rregullimi i shtratit te lumit „Silnica" kodit (51830).....	110,000.00 €
6.2. Bujqësia (47024), në projektet:	
Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica kodit (52290).....	43,813.04 €
<b>7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.</b>	
<b>8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për shpenzimet operacionale dhe tabela e shpenzimeve kapitale.</b>	

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga fondi 21 nga viti 2022 në vitin 2023;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerët abstenim vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

1.1. Paga dhe Meditje.....	10,000.00 €
1.2. Mallrat dhe Shërbimet.....	619,076.38 €
1.3. Shpenzimet komunale.....	5,000.00 €
1.4. Subvencionet dhe Transferet .....	55,100.00 €
1.5. Shpenzime kapitale .....	896,440.56 €
<b>Totali.....</b>	<b>1,585,616.94 €</b>

2. Në kategorinë Mallrat dhe shërbimet, bartja bëhet si në vijim:

2.1. Zyra e kryetarit (16024), shuma prej.....	30,000.00 €
2.2. Administrata (16324), shuma prej.....	10,000.00 €
2.3. Inspektimet (16647), shuma prej.....	3,000.00 €
2.4. Zyra e Kuvendit Komunal (16924), shuma prej.....	1,000.00 €
2.5. Buxhetimi (17524), shuma prej.....	2,000.00 €
2.6. Infrastruktura publike (18184), shuma prej.....	150,000.00 €
2.7. Menaxhimi i fatkeqsive natyrore, (18468) shuma prej.....	50,000.00 €
2.8. Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), shuma prej.....	75,000.00 €
2.9. Administarta (73033), shuma prej.....	1,300.00 €
2.10. Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej.....	40,000.00 €
2.11. Shërbimet Sociale-Vushtrri (75616), shuma prej.....	950.38 €
2.12. Shërbimet kulturore (85024), shuma prej.....	6,000.00 €
2.13. Administrata (92120), shuma prej.....	208,915.00 €
2.14. Arsimiti parshkollor (92670), shuma prej.....	34,329.00 €
2.15. Arsimiti i mesëm i lartë (94890), shuma prej.....	6,582.00 €

3. Në kategorinë ekonomike shpenzimet komunale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:

3.1. Infrastruktura publike (18184), shuma prej.....	5,000.00 €
--	------------

4. Në kategorinë ekonomike Subvencionet dhe Transferet bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:

4.1. Zyra e kryetarit (16024), shuma prej.....	40,000.00 €
4.2. Administarta (73033), shuma prej.....	10,000.00 €

- 4.3.** Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), shuma prej.....**100.00 €**  
**4.4.** Administrata (92120), shuma prej.....**5,000.00 €**

**5.** Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale bartja e mjeteve finciare bëhet si në vijim:

**5.1.Administrata (16324), në projektet:**

- 5.1.1** Ngrohja qendrore për administratën Komunale kodit (51814), shuma prej.....**15,000.00 €**

**6. Infrastruktura publike (18184), në projektet:**

- 6.1.** Sinjalizimi horizontal dhe vertikal rr."Dëshmorë e Kombit" kodit (51822), shuma prej.....**19,821.00 €**  
**6.2.** Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara "2 Maji", "Hamit Hyseni"kodit (51828), shuma prej.....**20,000.00 €;**  
**6.3.** Ndriçimi publik në Vushtrri, Doberrlukë, Maxhunaj, Stanoc kodit (51831), shuma prej.....**584.00 €**  
**6.4.** Rregullimi i shtratit të lumit „Silnica" kodit (51830) shuma prej.....**110,000.00 €**  
**6.5.** Ndërtimi i trotuareve në Vushtrri, Stanoc, Smrekonicë kodit (51821),shuma prej.....**1,070.00 €**  
**6.6.** Rregullimi i kabllave "Adem Jashari",kodit (i ri), shuma prej.....**19,000.00 €**

**7.** Shërbimet kulturore (85024), në projektin:

- 7.1.** Ndërtimi pllakave përkujtimore në Pasomë (51851), shuma prej.....**20,000.00 €**  
**7.2.** Renovimi i palestës "Jeton Tërstena" (51007), shuma prej.....**29,901.00 €**  
**7.3.**Ndërtimi i objektit ndihmës në stadiumin „Ferki Aliu" (51847), shuma prej.....**20,000.00 €**

**8.** Bujqësia (47024), në projektet:

- 8.1.** Projektet në bashkëfinancim me donatorë kodit (49561) ), shuma prej **82,240.00 €**  
**8.2.**Rregullimi dhe pastrimi i lumit Llap- Silnica kodit (52290), shuma prej **60,000.00 €**

**9.** Planifikimi urban dhe inspeksioni (66425), në projektet:

- 9.1.** Asfaltimi i rr. Vesekoc – Sllakovc (53584), shuma prej.....**80,000.00 €**  
**9.2.** Ndërt.rrug.lokale në fshatra kodit (41424), shuma prej.....**166,623.00 €**  
**9.3.** Ndërtimi i parkut në Stanoc, kodit (i ri) , shuma prej.....**50,185.00 €**  
**9.4.** Mbjellja e drunjve dekorativ kodit (49588), shuma prej.....**3,000.00 €**

**10. Shërbimet e shëndetësisë primare (74450), në projektet:**

- 10.1.** Automjet i terrenit për shëndetësi kodi (50059), shuma prej.....**8,500.00 €**
- 10.2.** Ndërtimi i zyrave administrative në QKMF (52190), shuma prej.....**31,000.00 €**
- 10.3.** Laboratori në Lumadh (I RI), shuma prej.....**3,042.00 €**

**11. Shërbimet Rezidenciale – Vushtrri (75617), në projektin:**

- 11.1** Blerja e veturës për Shërbimet rezidenciale kodi (53625), shuma prej....**5,000.00 €**

**12. Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93690), në projektet:**

- 12.1.** Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa" kodi (51870), shuma prej.....**3,833.00 €**
- 12.2.** Meremetimi i SHFMU "Mihaliq" kodi (51869), shuma prej.....**550.00 €**
- 12.3.** Meremetimi i SHMU "Enver Hadri" kodi (51866), shuma prej.....**950.00 €**
- 12.4.** Renovimi i shf "Ali Kelmendi" kodi (53055), shuma prej.....**6,355.00 €**
- 12.5.** Renovimi i SHFMU "Adem Voca " Pasomë kodi (53060), shuma prej.....**1,550.00€**
- 12.6.** Ndertimi i toaleteve ne SHMU"Emin Duraku" kodi (51854),shuma prej.....**44,319.56 €**
- 12.7.** Ndertimi i punetorise dhe kabineteve ne SHMT"Lutfi Musiqi" kodi (46561), shuma prej.....**16,992.00 €**
- 12.8.** Ndertimi i fushes sportive dhe rrethojes ne SHFMU-Smrekonice kodi (51853), shuma prej.....**10,270.00 €**
- 12.9.** Ndertimi i rrethojes ne Oshlan kodi (51862), shuma prej.....**1,564.00 €**
- 12.10.** Ndertimi i rrethojes ne Vilanc kodi (51863), shuma prej.....**1,346.00 €**
- 12.11.** Meremetimi i SHMU-1 kodi (49561), shuma prej.....**7,950.00 €**
- 12.12.** Renovimi i shkolles"Hajrullah Shala" ne Akrashtice kodi (49561), shuma prej.....**6,157.00 €**

**13. Arsimi i mesëm i lartë (94890), në projektet:**

- 13.1.**Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha" kodi (51874), shuma prej.....**36,699.00 €**
- 13.2.**Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi"SHMU II kodi (51875), shuma prej.....**12,939.00 €**



**8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023;**

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-sqaroi** se të hyrat vetanake nga fondi 21 si dhe të hyrat e tejkualuar barten me automatizëm sepse kjo është e paraparë me ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2023, ndërsa është diskutabile a do të barten të hyrat nga fondi 22 i vitit 2022 dhe për këtë jemi duke pritur një informatë nga Ministria e Financave.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi** se në këtë situatë kur nuk dihet se çfarë do të vendos Qeveria e Kosovës, ne jemi shkuar me tri alternativa. Të hyrat e grumbulluara nga viti 2021 ato do të lejohen të barten, ndërsa është e pa qartë se çfarë do të ndodh me të hyrat e vitit 2021 a do ti merr Qeveria e Kosovës apo do t'i i 'u bartë komunave. Andaj me qëllim të mos bllokimit të procesit është shkuar me tri variante nëse i aprovon qeveria atëherë i kemi vendimet e miratuara nga ana e kuvendit.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për” të tjerët abstenim vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet bartja e të hyrave vetanake për vitin 2022 në vitin 2023 në kategoritë si në vijim:

1.1 Paga dhe mëditje .....	10,000.00 €
1.2 Mallra dhe shërbime.....	1,006,430.81 €
1.3 Shpenzime komunale.....	10,000.00 €
1.4 Subvencione dhe transfere.....	170,100.00 €
1.5 Investime kapitale.....	1,537,096.56 €

**Totali i mjeteve të bartura.....2,733,627.37 €**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

**9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit i vlerësimit të dëmeve nga shiu, era dhe zjarri;**

**Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit** –tha se në bazë të këtij raporti del se në fund të viti 2022 dhe fillim të viti 2023 ka pasur vërshime dhe ato kanë prekur disa familje në ekonominë e tyre familjare. Kjo e demanton faktin se nuk pasur fare dëme dhe se gjendja ka qenë nën kontroll siç ka pretenduar kryetari i komunës. Megjithatë e përshëndet projektin për pastrimin e lumenjve dhe prrockave që ndikon në mënjanimin e vërshimeve, gjatë motit të ligë.

**Agim Miftari, zyrtarë në Drejtorinë për Emergjencë-paraqiti** sqarime lidhur me raportin në fjalë në cilësinë e kryesuesit të Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga shiu, era dhe zjarri.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë, për përuhdhën nëntor –dhjetor 2022 dhe janar, shkurt-mars 2023.

2. Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në teren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (vërshimet, zjarret dhe erërat e forta) që kanë mbretëruar në periudhën e sipër cekur në Komunën e Vushtrrisë.

3. Komisioni i cekur më lartë ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkulua shumat e mjeteve financiare të shkaktuara dëm në vlerë totale prej **110,096.73 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare, këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera në Komunën e Vushtrrisë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale;

**Edona Gashi, anëtare e kuvendit-** pyeti komisionin se përse nuk janë përfillur kriteret që dalin nga rregullorja gjatë procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale konkretisht paragrafi 4 i nenit 9 ku thuhet: takimet kanë legjitimitet juridik, nëse të pranishëm janë së paku 30 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, duke respektuar kuotën gjinore prej 30% të gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe përfaqësimin etnik në lokalitete ku ka banorë të komuniteteve jo shumicë. Andaj bazuar në raport del se nga 25 Këshilla Lokal të themeluar në përbërjen e tyre kemi vetëm një femër, e që i bie se këto këshilla janë themeluar në kundërshtim me rregulloren në fuqi.

**Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit-**tha se komisioni ka kryer një punë të jashtëzakonshme duke mbajtur takimet dhe në kohë rekord i ka zgjedhur këshillat lokal në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë gjë për të cilën meriton mirënjohje dhe falënderim. Tutej shtoj dhe njoftoj se rregullorja është hartuar në kundërshtim me udhëzimin administrativ dhe pikërisht për këtë është rekomanduar të bëhet plotësim-ndryshimi i saj. Ai sqaroi se disa takim janë anuluar pikërisht për shkak të mungesës së kuorumit prej 30 pjesëmarrës dhe është përsëritur mbledhja.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**pasi falënderoj anëtarët e komisionit për punën ekipore që ka bërë, shtoj se pretendimi se vetëm në një femër është zgjedhur në këshillat e fshatrave është i paqëndrueshëm, sepse ai lexoj disa emra të këshillave lokal ku janë zgjedhur femra duke e demantuar kështu deklaratën e znj.Edona Gashi anëtare e kuvendit. Më tej shtoj se në disa lokalitetet ka pasur numë të madh të pjesëmarrësve edhe nga gjinia femërore si në Stanoc të Poshtëm dhe të Epërm në Stroc, ndërsa në disa të tjera pjesëmarrja ka qenë më e ulët. Ai kritikoj që prej dymbëdhjetë asamblistëve që ka kuvendi i komunës në këto takim ka marrë pjesë vetëm dy prej tyre Melihate Basholli dhe Blerina Shala. Në vazhdim ai lexoj para kuvendit listën e kryetarëve të fshatrave që janë zgjedhur.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se janë evidentuar shkelje të rregullores gjatë procesit të zgjedhjes së këshillave lokale, ndërsa procesi i zgjedhjes së tyre ka filluar para se rregullorja të hyn në fuqi.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit**-tha se të kritikosh një punë që është bërë zellshëm për zgjedhjen e këtyre këshillave është vërtet për tu ndier keq dhe me mllef, sepse zgjedhja e këtyre këshillave është bërë në formën më të mirë të mundshme. Jepen letra për t'i lexuar deputetëve të rinj nga njerëzi të cilët kanë shkelur në çdo punën dhe aktivitet që kanë krye, kjo vërtet është për keqardhje. Kjo me fjalë tjera i bie se puna e mirë nuk vlerësohet në këtë kuvend.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës**-tha se e vlerëson larë punën e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, dhe potencoi se është bërë një punë jashtëzakonisht e mirë pas këta trupa janë me rëndësi për komunën për adresimin e problemeve dhe projekteve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Më tej njoftoj se janë në përpjekje për hartimin kartelave identifikuese për kryetaret e këshillave lokal.

**Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 24 vota “për” aprovoj Raportin e komisionit për përzgjedhjen e Këshillave Lokale të Komunës së Vushtrrisë.**

**11. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale për vitin 2022;**

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-tha se shifrat e publikuara në këtë informatë vërtet janë për keqardhje ku shihet se nga këto qira janë inkasuar vetëm 2155 €, ndërsa akoma nuk është ndërmarr asnjë veprim i komunës për lirimin e këtyre shfrytëzuesve nga obligimet komunale me qëllim të lehtësimit të zhvillimi të veprimtarisë së tyre. Lidhur me kërkesën për një zyrtar për menaxhimin e kontratave tha se kjo është një kërkesë plotësisht me vend.

**Bekim Zaberija, anëtar i kuvendit**-tha se paraardhësi i drejtorit të DGJKP-së në mandatin e kaluar ka lënë shumë probleme, sepse paramendon Drejtoria për Kadastër nuk e ka pasur të funksionalizuar Sektorin për Pronë. Kërkoj që ky sektor të funksionalizohet sa më parë.

**12. Shqyrtimi i propozimit për ofrimin e ndihmës financiare për Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt si rezultat i dëmeve nga vërshimet, si dhe ofrimin e ndihmës financiare për Shtetin e Turqisë dhe Sirisë si pasojë e tërmetit;**

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit**-tha se ky propozim ka dal nga Komitetit për Politikë dhe Financa, por me që ka ndryshuar rrethanat në fondet e komunës ku qeveria pretendon ti merr një pjesë të mjeteve të bartura atëherë kjo çështje le të mbetet në kompetencën e zyrës së kryetari që ta vendosë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit**-tha se është mirë që tu dilet në ndihmë atyre që kanë nevojë, por ne e dimë se ka mungesë të fondeve, dhe kemi edhe shumë nevojtar në komunën tonë, andaj duhet ti kemi parasysh njerëzit tanë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit**-tha se ne jemi solidarizuar me vëllezërit tanë në Komunën e Mitrovicës dhe Skënderajt dhe kemi ndje dhimbje, por kur bëhet fjalë për ndihma ne kemi familje që janë dëmtuar nga vërshimet qysh në vitin 2019 dhe atyre familjeve nuk i'u është bërë akoma një zgjidhje dhe janë të paktën tri familje që nga ajo kohë jetojnë me qira. Në këtë aspekt kërkoj nga Drejtoria e Emergjencave që të evidentoj se sa familje kemi që kanë pësuar dëme nga vërshimet që nga vitet 2019-2020-2021 dhe 2022, ashtu që të gjendet një zgjidhje për to.

**13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për caktim të kahjeve të lëvizjes në disa rrugë të qytetit;**

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit**-njoftoi se me këto rrugë duhet të gjendet një zgjidhje, për shkak se kemi një dyndje me mjete motorike sidomos këtu afër komunës, si grup i LDK deklaroi se do ta mbështesin këtë propozim-vendim.

**Islam Latifi, zyrtar në DSHP**-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se tashmë jo vetëm pjesa e ngopur e komunikacionit afër objektit të Komunës por tani kemi konfirmim të kërkesë sonë nga UNHABITAT për mbështetjen në hartimin e planit të mobilitetit të Komunës së Vushtrrisë.

**Mek Selaci, anëtar i kuvendit**-pyeti se nëse rruga “Isa Boletin” bëhet rrugë një kahëshe atëherë kahja tjetër e rrugës a do të shfrytëzohet si parking për vetuar e që kjo do ti pengonte banorët që banojnë përgjatë kësaj rruge.

**Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 25 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Rruga qarkulluese „Weslli Klark” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes në drejtim të rrugës „Ruzhdi Hyseni”.

2. Segmenti i parë i rrugës qarkulluese „Ismail Qemajli” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes, në drejtim të rrugës „Haxhi Zeka”

3. Rruga qarkulluese „Ruzhdi Hyseni” caktohet rrugë me një kahe të lëvizjes në drejtim të rrugës rrugës – sheshit „Hasan Prishtina”.

4. Rruga qarkulluese „Isa Boletini” përcaktohet rrugë me një kahe të lëvizjes nga kryqëzimi me sheshin - rrugën „Hasan Prishtina” në drejtim të rr. „Zenullah Begu”.

5. Në rrugën qarkulluese me një kahe të lëvizjes „Hasan Prishtina” ndalohet ndalja dhe parkimi për mjetet me veprim motorik.

6. Rruga „Ramadan Fazliu” rezervohet për parkimin e taksive individual.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspektimeve e Komunës së Vushtrrisë.

**14. Rishqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e Planit Lokal për veprim në Mjedis;**

**Fortuna Krasniqi, drejtoreshë e DUMM-së**-sqaroi se ky planë është aprovuar para dy seancave, por që Ministria e Mjedisit ka kërkuar të bëhen disa plotësime të cilat janë inkorporuar në plan, ndërsa kërkoj që të bëhet korrigjimi i bazës juridike të këtij vendimi.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim miratohet Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2023-2026

2. Për zbatimin e këtij plani obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2023-2026.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

15. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202063-0028-0, me kulturë arë e klasës së 5 (pestë), në sipërfaqe prej 107 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja totale 4180m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Strofc, pronë e Blerim Hasanit, i cili i ka dhënë në shfrytëzim parcelën në fjalë - Hasan Hasani si qiramarrës me Kontratë mbi qiranë e paligjshmërisë me Nr. protokollit. LRP/Nr.Ref.3284/13252/2022 tek noteri Bardhyl Dinaj me seli në Vushtri.

2. Qëllimi i lejitimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit me destinim Dhomë Mjalti me etazhitet P+0.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën ”b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

16. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim – vendimit për formimin e komisionit për ndryshim-plotësimin (**hartimin**) e Rregullores për Punën e Kuvendit dhe Organeve të tij.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshim-plotësimin (hartimin) e Rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij, në përbërjen si në vijim:

- 1.1. Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e Kuvendit (PDK);**
- 1.2. Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit (LDK);**
- 1.3. Mek Selaci, anëtar i kuvendit (LVV);**
- 1.4. Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit (Nisma Socialdemokrate) dhe**
- 1.5. Bastri Duraku, nga sekretaria e kuvendit.**

**2.** Komisioni i cekur në pikën një (1) të këtij vendimi, do të bëjë plotësim-ndryshimin (hartimin) e draftit të kësaj rregulloreje dhe të njëjtën do ta procedojë në kuvend për aprovim.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e komisionit të cekur në pikën një (1) të këtij vendimi.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora: 15:10.**

**Bastri Duraku**

---

**Procesmbajtës**

**Melihate Basholli-Latifi**

---

**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

<b>DATE/A:</b>	13.04.2023
<b>PËR/ZA/TO:</b>	KPF dhe Kuvend
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës Abit Abiti, ZKF
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Raporti tremujor , Janar – Mars

Në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit nr. 03/L – 048, Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur raportin tremujor i cili mbulon vitin fiskal e deri në fund të këtij tremujori i cili sapo ka përfunduar. Ky raport përmban shënime mbi arkëtimet , shpenzimet dhe një përmbledhje të shpenzimeve Kapitale . Këtë raport e prezentojmë në KPF , pas shqyrtimit nga KPF ky raport i prezantohet Kuvendit Komunal dhe një kopje të këtij raporti ja dërgojmë edhe Ministrisë.

Me respekt.

Shtojcë Raportet:

Emri i Komunës :		K.K.VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:		644								
Periudha raportuese		Janar - Mars 2023								
<b>TE HYRAT VETANAKE (THV) SIPAS DREJTORIVE DHE KODIT EKONOMIK</b>										
Përshkrimi	Kodi	Periudha raportuese			Vjetore				Viti i kaluar	
		Buxheti i planifikuar për PR	Të hyrat e realizuar në PR	Përqindja e buxhetit të realizuar për PR	Buxheti i planifikuar për 2023	Buxheti i mbetur për 2023	Plani i revduar	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të revduar		Te hyrat e realizuara ne periudhen e njejte 2022
		4	5	6 = 5/4*100	7	8= 7-5	9	10 = 7-9	11	
<b>Administrata dhe personell</b>	<b>163</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Taksa administrative		25,000.00	17,989.00	72%	100,000.00	82,011.00	0.00	100,000.00	17,469.00	
<b>TOTAL</b>		<b>25,000.00</b>	<b>17,989.00</b>	<b>72%</b>	<b>100,000.00</b>	<b>82,011.00</b>	<b>0.00</b>	<b>100,000.00</b>	<b>17,469.00</b>	
<b>Inspeksioni</b>	<b>166</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Pranime teknike		1,250.00	3,725.00	298%	5,000.00	1,275.00	0.00	5,000.00	1,245.00	
Pelqimet sanitare				0%		0.00	0.00	0.00	1,275.00	
Gjjobat e Inspeksionit		1,250.00	1,500.00	120%	5,000.00	3,500.00	0.00	5,000.00		
<b>TOTAL</b>		<b>2,500.00</b>	<b>5,225.00</b>	<b>209%</b>	<b>10,000.00</b>	<b>4,775.00</b>	<b>0.00</b>	<b>10,000.00</b>	<b>2,520.00</b>	
<b>Buxheti dhe Financa</b>	<b>175</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Taksat e firmave		3,750.00	8,250.00	220%	15,000.00	6,750.00	0.00	15,000.00	14,250.00	
Tatimi në pronë		288,036.00	270,824.05	94%	1,152,144.00	881,319.95	0.00	1,152,144.00	200,854.34	
<b>TOTAL</b>		<b>291,786.00</b>	<b>279,074.05</b>	<b>96%</b>	<b>1,167,144.00</b>	<b>888,069.95</b>	<b>0.00</b>	<b>1,167,144.00</b>	<b>215,104.34</b>	
<b>Arsimi</b>	<b>900</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
<b>Shtjja e prodhimeve</b>										
Participimi në çerdhen		15,000.00	19,522.00	130%	60,000.00	40,478.00	0.00	60,000.00	11,643.00	
Shkolla e Mesme Teknike		3,750.00	4,859.00	130%	14,000.00	9,141.00	0.00	14,000.00	4,620.00	
Shkolla e Mesme Profesionale		3,500.00	5,210.00	149%	15,000.00	9,790.00	0.00	15,000.00	5,860.00	
<b>TOTAL</b>		<b>22,250.00</b>	<b>29,591.00</b>	<b>133%</b>	<b>89,000.00</b>	<b>59,409.00</b>	<b>0.00</b>	<b>89,000.00</b>	<b>22,123.00</b>	
<b>Gjeodezi dhe Kadastër</b>	<b>650</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Tatimi nga Gjeodezia dhe Kadastër		17,500.00	27,442.00	157%	70,000.00	42,558.00	0.00	70,000.00	30,467.00	
Qiraja nga objektet publike		5,750.00	3,000.00	52%	23,000.00	20,000.00	0.00	23,000.00	2,155.00	
<b>TOTAL</b>		<b>23,250.00</b>	<b>30,442.00</b>	<b>131%</b>	<b>93,000.00</b>	<b>62,558.00</b>	<b>0.00</b>	<b>93,000.00</b>	<b>32,622.00</b>	
<b>Kultura, Shport dhe Recreacioni</b>	<b>850</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Palestra e sportit		250.00	120.00	48%	1,000.00	880.00	0.00	1,000.00	48.00	
Biblioteka		125.00		0%	500.00	500.00	0.00	500.00		
Shtëpia e Kulturës		250.00		0%	1,000.00	1,000.00	0.00	1,000.00		
<b>TOTAL</b>		<b>625.00</b>	<b>120.00</b>	<b>19%</b>	<b>2,500.00</b>	<b>2,380.00</b>	<b>0.00</b>	<b>2,500.00</b>	<b>48.00</b>	
<b>Shërbime publike</b>	<b>180</b>	€	€	%	€	€	€	€	€	
Parkingjet		500.00	485.00	97%	2,000.00	1,515.00	0.00	2,000.00	880.00	
Regjistrimi i automjeteve		30,000.00	34,476.00	115%	120,000.00	85,524.00	0.00	120,000.00	30,250.50	
Taksat e mbeturinave		189,000.00	150,469.54	80%	756,000.00	605,530.46	0.00	756,000.00	130,734.49	
<b>TOTAL</b>		<b>219,500.00</b>	<b>185,430.54</b>	<b>84%</b>	<b>878,000.00</b>	<b>692,569.46</b>	<b>0.00</b>	<b>878,000.00</b>	<b>161,864.99</b>	



Prokurimi									
Bujqësi	470	€	€	%	€	€	€	€	€
Ndryshimi i destinimit		3,750.00	15,218.00	406%	15,000.00	-218.00	0.00	15,000.00	3,637.00
Shitja e Drujve									
Leje pune									
<b>TOTAL</b>		<b>3,750.00</b>	<b>15,218.00</b>	<b>406%</b>	<b>15,000.00</b>	<b>-218.00</b>	<b>0.00</b>	<b>15,000.00</b>	<b>3,637.00</b>
Shëndetës	700	€	€	%	€	€	€	€	€
Participim		12,500.00	12,911.55	103%	50,000.00	37,088.45	0.00	50,000.00	11,227.50
Participim QPS		500.00	1,170.00	234%	2,000.00	830.00	0.00	2,000.00	830.00
<b>TOTAL</b>		<b>13,000.00</b>	<b>14,081.55</b>	<b>108%</b>	<b>52,000.00</b>	<b>37,918.45</b>	<b>0.00</b>	<b>52,000.00</b>	<b>12,057.50</b>
Urbanizmi	660	€	€	%	€	€	€	€	€
Lejet e ndërtimit		105,978.75	65,994.88	62%	423,915.00	357,920.12	0.00	423,915.00	181,457.20
leje mjedisore		12,500.00	50.00		50,000.00				14,897.28
Legalizim i Objekteve		3,750.00	11,441.37		15,000.00				491.61
Rrenim i objekteve			668.64						
Shfrytëzimi i pronës P		1,250.00	240.00	19%	5,000.00	4,760.00	0.00	5,000.00	3,984.20
<b>TOTAL</b>		<b>123,478.75</b>	<b>78,394.89</b>	<b>63%</b>	<b>493,915.00</b>	<b>362,680.12</b>	<b>0.00</b>	<b>428,915.00</b>	<b>200,830.29</b>
	850	€	€	%	€	€	€	€	€
Gjobat e pyjeve			530.00						200.00
Të hyrat tjera			521.20	#VALUE!		-521.20	0.00	0.00	20,873.00
<b>TOTAL</b>		<b>0.00</b>	<b>1,051.20</b>	#DIV/0!	<b>0.00</b>	<b>-521.20</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>21,073.00</b>
		<b>725,139.75</b>	<b>656,617.23</b>	<b>91%</b>	<b>2,900,559.00</b>	<b>2,243,941.77</b>	<b>0.00</b>	<b>2,835,559.00</b>	<b>689,349.12</b>
Sqarim:									
Planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar-Mars 2023 është 2,262,795.00euro,realizim është 725,139.75euro, shprehur në përqindje 90.55% realizimi,									

#REFI	K.K.Vushtri																		
#REFI	644																		
Periudha raportuese		Janar - Mars																	
<b>PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT</b>																			
<b>PERIUDHA RAPORTUESE</b>										<b>VIETORE</b>									
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>KODI</b>	<b>BUXHETI I PLANIFIKUAR</b>	<b>Shpenzimet të realizuar në PR</b>	<b>Përqindja e nuxhetit të alokuar</b>	<b>Buxheti i planifikuar për 2023</b>	<b>Buxheti i mbetur për 2023</b>	<b>Plani i reviduar 2023</b>	<b>Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar</b>	<b>Shpenzimi i realizuar për periudhën e njëjtë 2022</b>										
	4	5	6 = 5/4*100 %	7	8=7-5	9	10 = 7-9	11											
	€	€	%	€	€	€	€	€											
Finacimi nga huamarrjet	04			0%	0.00	0.00	0.00	0.00											
Granti Qeveritar	10	3,856,767.85	3,516,840.41	91%	20,486,582.55	16,969,742.14	0.00	20,486,582.55											2,928,068.13
Të hyrat vetanake	21	471,084.37	202,526.29	43%	2,900,559.00	2,698,032.71	0.00	2,900,559.00											
Mjetet e bartura	22			0%	0.00	0.00	0.00	0.00											
Donacionet e brendshme	31	5,471.23		0%	5,471.23	5,471.23	0.00	5,471.23											20,825.39
Donacionet e jashtme	32	19,686.17		0%	19,686.17	19,686.17	0.00	19,686.17											
<b>TOTALI</b>		<b>4,353,009.62</b>	<b>3,719,366.70</b>	<b>85%</b>	<b>23,412,298.95</b>	<b>19,692,932.25</b>	<b>0.00</b>	<b>23,412,298.95</b>											<b>2,948,893.52</b>
Sgarim:																			
Granti Qeveritar kod ekonomik 10,Buxheti i planifikuar është 3,856,767.85 euro,Buxheti i shpenzuar është 3,516,840.41euro,Realizimi është 91%																			
Të hyrat vetanake kod ekonomik 21,Buxheti i planifikuar është 471,084.37euro,Buxheti i shpenzuar është 202,526.29euro,Realizimi është 43%																			
Mjetet e bartura kod ekonomik 22,ende nuk jon alokuar.																			
Donacionet e brendeshme kod ekonomik 31,Buxheti i planifikuar është 5,471.23euro																			
Donacionet e jashtme kod ekonomik 32,Buxheti i planifikuar është 19,686.17euro,																			
<b>Konkloidojm se Buxheti i planifikuar është 4,353,009.62euro,Buxheti i shpenzuar është3,719,366.70 euro,Realizimi është 85%</b>																			

Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit me rezervuar për fshat

Komuna	VUSHTRRI	PERIUDHA RAPORTUESE		VLETORE			Viti I kaluar		
Kodi	644	BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2023	Buxheti I mbetur për 2023	Plani I reviduar 2023	Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar	Shpenzimi I realizuar për periudhën e njëjtë 2022
Periudha raportuese	Janar - Mars								
<b>PËRMLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE TË LARTA TË SHPENZIMEVE</b>									
<b>PËRSHKRIMI</b>	<b>KODI</b>	<b>PERIUDHA RAPORTUESE</b>		<b>VLETORE</b>			<b>Viti I kaluar</b>		
		4	5	6 = 5/4*100 %	7	8 = 7-5	9	10 = 7-9	11
		€	€		€	€	€	€	€
Paga dhe mëditje	111	2,849,477.85	2,847,714.85	100%	10,809,604.55	7,961,889.70	0.00	10,809,604.55	2,470,715.80
Mallra dhe shërbime	130	1,150,357.86	750,345.90	65%	3,904,347.45	3,154,001.55	0.00	3,904,347.45	356,942.78
Shpenzimet komunale	132	146,150.00	82,435.95	56%	472,500.00	390,064.05	0.00	472,500.00	62,257.94
Subvencionet dhe transferet	200	100,000.00	38,870.00	39%	942,000.00	903,130.00	0.00	942,000.00	38,270.00
Investimet kapitale	300	107,023.91		0%	7,283,846.95	7,283,846.95	0.00	7,283,846.95	20,707.00
Rezerva						0.00			
<b>TOTALI</b>		<b>4,353,009.62</b>	<b>3,719,366.70</b>	<b>85%</b>	<b>23,412,298.95</b>	<b>19,692,932.25</b>	<b>0.00</b>	<b>23,412,298.95</b>	<b>2,948,893.52</b>
Sgarim:									
Paga dhe mëditje kodit ekonomik 111,Buxheti I planifikuar është 2,849,477.85euro,Buxheti I shpenzuar është 2,847,714.85euro,Realizimi është 100%									
Mallra dhe shërbime kodit ekonomik 130,Buxheti I planifikuar është 1,150,357.86euro,Buxheti I shpenzuar është 750,345.90euro,Realizimi është 65%									
Shpenzimet komunale kodit ekonomik 132,Buxheti I planifikuar është 146,150euro,Buxheti I shpenzuar është 82,435.95euro,Realizimi është 56%									
Subvencionet dhe transferet kodit ekonomik 200,Buxheti I planifikuar është100,000euro,Buxheti I shpenzuar është 38,870.00euro,Realizimi është 39%									
Investimet kapitale kodit ekonomik 300,Buxheti I planifikuar është 107,023.91euro,									
<b>Konkludojm se Buxheti I planifikuar është 4,353,009.62euro,Buxheti I shpenzuar është 3,719,366.70 euro,Realizimi është 85%</b>									

Emri i Komunës :	VUSHTRRI								
Kodi i Komunës:	644								
Periudha raportuese	Janar - Mars								
<b>PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE</b>									
PËRSHKRIMI	KODI	PERIUDHA RAPORTUESE			VETORE			Viti i kaluar	
		BUXHETI I PLANIFIKUAR	Shpenzimet të realizuar në PR e buxhetit të alokuar	Përqindja e nuxhetit të alokuar	Buxheti I planifikuar për 2023	Buxheti I mbetur për 2023	Plani I reviduar 2023		Dallimi në mes të buxhetit të planifikuar dhe planit të reviduar
		€	€	%	€	€	€	€	
Zyra e Kryetarit	160	86,508.81	73,219.73	85%	347,406.00	274,186.27	0.00	347,406.00	44,238.27
Administrata dhe personeli	163	141,435.71	102,229.44	72%	514,052.93	411,823.49	0.00	514,052.93	58,104.23
Inspektimet	166	28,308.76	17,608.76	62%	134,683.00	117,074.24	0.00	134,683.00	18,586.61
Prokurimi	167	11,078.15	8,578.15	77%	55,360.93	46,782.78	0.00	55,360.93	6,181.85
Zyra e Kuvendit Komunal	169	64,901.43	62,501.43	96%	141,264.99	78,763.56	0.00	141,264.99	31,825.29
Buxheti dhe financat	175	44,256.20	38,502.20	87%	197,918.00	159,415.80	0.00	197,918.00	36,150.99
Mbrojtja civile dhe emergjencia	180	719,105.86	419,625.89	58%	4,771,035.16	4,351,409.27	0.00	4,771,035.16	180,197.82
ZYRA TOKARE E komuniteteve	195	21,138.73	11,890.57	56%	70,079.00	58,188.43	0.00	70,079.00	11,642.89
Bujqesi, pylltari, zivillimi rural	470	57,408.48	22,415.48	39%	555,872.92	533,457.44	0.00	555,872.92	20,883.96
Gjeodezi dhe Kadastër	650	20,204.73	17,204.73	85%	94,183.00	76,978.27	0.00	94,183.00	16,574.39
Planifikimi urban dhe mjedisi	660	34,373.83	15,279.12	44%	2,849,236.70	2,833,957.58	0.00	2,849,236.70	32,601.66
Shëndetësia primare	730	576,751.17	515,246.19	89%	3,269,703.64	2,754,457.45	0.00	3,269,703.64	501,825.63
Shërbimet sociale rezidenciale		57,195.56	47,454.45	83%	319,154.00	271,699.55	0.00		38,488.21
Kulturë, rini, sport	850	67,532.36	44,319.00	66%	453,264.65	408,945.65	0.00	453,264.65	41,597.48
Arsimi	920	2,422,809.84	2,323,291.56	96%	9,639,084.03	7,315,792.47	0.00	9,639,084.03	1,909,994.24
<b>TOTALI</b>		<b>4,353,009.62</b>	<b>3,719,366.70</b>	<b>85%</b>	<b>23,412,298.95</b>	<b>19,692,932.25</b>	<b>0.00</b>	<b>23,412,298.95</b>	<b>2,948,893.52</b>

Kodi I komunës:  
 Periudha raportuese

VUSHTRRI  
 644  
 Janar - Mars 2023

KODI	Mallrat dhe shërbimet	2023	2022
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13132	Akomodimi I udhëtimit zyrtar brenda vendit		
13133	Shpenzimet e tjera të-udhëtimit zyrtar brenda vendit	184.10	216.24
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	3,609.82	
13141	Shpenzimet të vogla -para xhepi	568.80	309.00
13142	Akomodimet e udhëtimit zyrtar jasht vendit	633.50	
13143	Shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jasht vendit	66.24	39.00
13310	Shpenzimet për internet	1,417.16	1,818.25
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	2,241.46	1,599.42
13330	Shpenzimet postare	357.80	233.30
13420	Shërbimet e perfaqsimi - avokaturë	2,844.00	
13430	Shërbime te ndryshme shendetësore	735.00	150.00
13440	Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	12,442.60	36.00
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	534,688.15	242,260.28
13470	Shërbime teknike		400.00
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)		493.00
13509	paisme tjera (më pak se 1000 euro)		11,241.00
13610	Furnizime për zyrë	3,219.00	9,271.68
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	9,064.10	2,270.82
13630	Furnizime mjekësore	16,725.43	2,990.50
13640	Furnizime pastrimi		514.50
13650	Furnizim me veshmbathje	992.50	
13655	Furnizim me preparate kimike		991.00
13710	vaj		303.00
13720	Nafte per ngrohje qendrore		18,006.16
13760	Dru	109,668.00	31,754.00
13770	Derivate per gjenerator	1,479.73	1,601.26
13780	Karburant per vetura	4,543.41	6,587.62
13790	Gas natyror		
13810	Avanc për para të imta	2,800.00	1,800.00
13820	Avanc për udhëtime zyrtare	27,245.70	3,139.00
13918	Provizion për tarifa të ndryshme	1,225.00	
13950	Regjistrimi i automjeteve		2,101.85
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	129.08	
14020	Mirembajtja e ndertesave		161.00
14023	Mirembajtja e shkollave		1,289.00
14040	Mirembajtja e teknologjisë informative		1,575.01
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paismeve	600.00	1,182.00
14130	Qiraja - paisme	1,807.84	2,040.85
14140	Qiraja -makineria	4,757.88	694.00

14220	Botimet e publikimeve		600.00
14230	Shpenzimet per informim publik	1,140.00	799.60
14310	Drekat zyrtare	5,159.60	5,863.50
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave		2,310.94
14415	Pagesat për tarifet-vendimet gjyqësore- përmbarimore		300.00
<b>13 TOTALI PËR MALLRA DHE SHËRBIME</b>		<b>750,345.90</b>	<b>356,942.78</b>

<b>14</b>			
13210	Rryma	61,584.42	51,076.29
13220	Uji	13,366.28	6,606.76
13230	Mbeturinat	5,885.92	4,040.90
13250	Shpenzimet telefonike	1,599.33	533.99
13260	Pagesa-vendime gjyqësore		
<b>14 TOTALI I SHPENZIMEVE KOMUNALE</b>		<b>82,435.95</b>	<b>62,257.94</b>

<b>20</b>	<b>SUBVENCIONET</b>		
21110	SUBVENCIONE PËR ENTITETET PUBLIKE	6,000.00	38,270.00
21200	SUBVENCIONE PËR ENTITETET JOPUBLIKE	32,870.00	
<b>20 TOTALI I SUBVENCIONEVE</b>		<b>38,870.00</b>	<b>38,270.00</b>
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE</b>		<b>871,651.85</b>	<b>457,470.72</b>



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës



**Datë:** 07.04.2023

**Për:** Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin Komunal

**Përmes:** Kryetarit të Komunës, Ferit Idrizi

**Nga:** Komisioni i Aksionarëve, Benjamin Shala

**Për shqyrtim:** INFORATË PËR RAPORTIN VJETOR TË PUNËS SË NDËRMARRJES  
REGJIONALE TË MBETURINAVE „UNITETI” PËR VITIN 2022

Të nderuar,

Raporti vjetor i punës së Ndërmarrjes Regjionale të Mbeturina „Uniteti” për vitin 2022, sipas Planit vjetor të punës së kuvendit për vitin 2022, është i planifikuar për diskutim në seancën e muajit prill, prandaj pas miratimit nga Bordi Drejtues po e sjellim për diskutim në këtë seancë.

Shtojcë:

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË NDËRMARRJES REGJIONALE TË UJËSJELLËSIT  
„MITROVICA” PËR VITIN 2022



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A, Mitrovicë

Për:	Bordin e Drejtorëve të KRM "Uniteti" Sh.A
Nga:	Z. Gazmend Morina, Kryeshef Ekzekutiv KRM "Uniteti" Sh.A Mitrovicë
Lënda:	<b>Raporti i punës për vitin 2022</b>
Datë:	05/01/2023

Të nderuar,

KRM "Uniteti" Sh.A, edhe në vitin 2022, me sukses ka arritur t'i kryej aktivitetet e saj në grumbullimin e mbeturinave duke e përbushë Planin Operativ 100%. Gjithashtu ka përbushë dinamikën e punëve edhe në fshirje e larje të rrugëve në regjionin e Mitrovicës. Duke marrë për bazë vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar në këtë periudhë qofshin ato në sektorin financiar apo operativ si dhe gjendjes pandemike në vend, kemi arritur që me sukses t'i përbushim aktivitetet primare dhe sekondare, qofshin ato në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, mirëmbajtjen verore në fshirje e larje të rrugëve, eliminimin e deponive ilegale, pastrimin e lumit Trepça nga mbeturinat, etj.

Viti 2022, karakterizohet me ngritjen e çmimit të derivateve që nga muaji shkurt. Kjo ngritje e çmimeve ka pasur ndikim edhe në përbushjen e detyrave dhe aktiviteteve tjera, si në pjesë rezervë për automjete/kamion, vajra, goma etj., duke shkaktuar vështirësi financiare. Për pasojë, kjo ngritje e çmimit të derivateve dhe në mënyrë që të shmangen shpenzime tjera shtesë, jemi detyruar që të tërhiqemi nga Projekti me titull "Java e Pastrimit me Unitetin" nën sloganin "Na pastrojmë çdo ditë, po sot hajde edhe ti!".

Në këtë periudhë raportuese, ka vazhduar zbatimi i marrëveshjeve për shërbime primare në Menaxhimin e Mbeturinave të lidhura ndërmjet Kompanisë dhe dy komunave (Mitrovicë dhe Vushtri). Vazhdon zbatimi i Marrëveshjeve për shërbime të veçanta të cilat kanë të bëjnë me eliminimin e deponive ilegale në hapësirat publike, qofshin ato në zonat urbane apo rurale e që përfshihen në territorin administrativ të Komunës së Mitrovicës dhe Skenderajt, si dhe marrëveshje tjera me vlera më të vogla të lidhura me institucione si Dogana e Kosovës, EULEX-i, Spitali Regjional "Sami Haxhibeqiri" etj.

Vlen të theksohet se marrëveshja e lidhur me Policinë e Kosovës e cila ka të bëjë me ofrimin e shërbimit në grumbullim të mbeturinave është e rëndësishë së veçantë duke pasur parasysh zhvillimet e fundit politike si dhe dislokimit të shumë trupave policore të Kosovës në veri të vendit, njëherësh nevojës dhe kërkesës së paraqitur për ofrimin e shërbimeve në grumbullim të mbeturinave në disa pika kulturore, si dhe duke marrë për bazë rolin vital të Policisë së Kosovës me rastin e kryerjes së detyrave të tyre.





Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A. Mitrovicë

Me marrëveshje nga 01.07.2022, inkasimi për ekonomi familjare kalon nga Komuna e Mitrovicës në kompetenca të Kompanisë, transferimi i regjistrave të klientëve nga softueri i komunës është bartë në fund të këtij muaji duke ndikuar kështu negativisht në financat e kompanisë. Përveç tjerash ky regjistër ka qenë i mangët me të dhënat si numri i klientëve për rreth 3,000 ekonomi familjare më i vogël, adresat e pasakta të klientëve e shumë probleme tjera teknike. Andaj, duke marrë për bazë të gjitha këto, kam organizuar dhe përzgjedhë stafin e punëtorëve për t'iu dalë në ndihmë inkasantëve në mënyrë që sa më parë të regjistrohen të gjitha ekonomitë familjare rezidente dhe jo rezidente në territorin administrativ të Komunës së Mitrovicës.

Vlen të theksohet se në muajin tetor kemi hapur një pikë/zyre për inkasim në afërsi të objektit të Komunës së Mitrovicës, kjo zyre ka për qëllim qasjen sa më të lehtë të qytetarëve me Kompaninë.

Siç edhe jeni të informuar falë punës dhe angazhimit maksimal të punëtorëve tanë në menaxhimin e mbeturinave e po ashtu edhe të atyre në mirëmbajtjen e hapësirave të qasshme për publikun, Komuna e Mitrovicës disa vite me radhë ka fituar grante për performancë. Në kuadër të këtij granti të performancës GIZ dhe KFW kanë shpërndarë për Kompanitë e Mbeturinave kamion kompaktor, derisa KRM "Uniteti", është pajisur me gjashtë kamion kompaktor me kilometrazhe zero, dy kamion janë të kapacitetit 16 m<sup>3</sup> ndërsa katër tjerë janë të kapacitetit 8 m<sup>3</sup>, secila Njësi Punuese është pajisur me nga dy kamion.

Prurjetimi njëvjeçarë kishte zigzagët e veta, të cilat, varësisht nga rrethanat, qofshin ato financiare, operative apo tjera, herë shfaqeshin si mundësi më të favorshme, e herë si pengesë për veprimtarinë tonë. Megjithatë, kemi arritur që për të gjitha blerjet/furnizimet t'i kryejmë obligimet tona kundrejt furnitorëve.

Po ashtu, vlen të theksohet se pagat për të gjithë punëtorët e Kompanisë janë ekzekutuar me rregull, derisa paga e muajit dhjetor është ekzekutuar me datë 28.12.2022.

Në shenjë vlerësimi për kontributin e dhënë gjatë gjithë vitit 2022, për punëtorët e Kompanisë, për çka edhe jemi krenar duke llogaritur punën e palodhshme të tyre, si dhe për t'u solidarizuar me ta për festën e vitit të ri, kemi ndarë buxhetin që në formë bonusi t'iu dhurojmë nga 50.00 € ( pesëdhjetë euro) secilit punëtor.

Me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së Komisionit Disiplinor dhe Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, kam vendosë që kohë pas kohe të ndryshoj përbërjen e anëtarëve të këtyre Komisioneve.

Në vitin 2022, është hartuar Plani i Punës për vitin 2023. Plan ky i cili është aprovuar unanimitisht nga Bordi i Drejtorëve duke vlerësuar punën dhe të arriturat e dukshme në Kompani.

Vlen të theksohet se viti 2022 karakterizohet me një sërë kontratash me vlerë të mesme, të vogël dhe minimale si:



Kompania Regjionale e Mbeturimave "Uniteti" S.H.A. Mitrovicë

1. Furnizim me mjete të punës
2. Furnizim me një kamion për bartjen e mbeturinave
3. Furnizim me vajra motorike dhe lubrifikant për automjete të rënda
4. Furnizim me pjesë për automjete
5. Furnizim me goma
6. Furnizim me lëndë djegëse/dru për ngrohje
7. Furnizim me një motor për makinën e rëndë kompaktuese Bomag
8. Furnizim me një kamion për bartjen e mbeturinave

Për blerjet e parapara në kompani kam urdhëruar që të zbatohen procedurat e prokurimit të parapara me ligj, sa i përket zyrës së prokurimit viti 2022. është përmbyllë me **36 procedura** të prokurimit duke i përfshirë vlerat e mesme të vogla dhe ato minimale.


Emërimi i kontrollës interne ka arritë efektin e saj, duke ndikuar pozitivisht tek të gjitha ekipet punuese në terren dhe duke ndikuar në çdo parregullsi të mundshme. Kjo për faktin se kontrollat interne janë bërë gjatë gjithë kohës pa paralajmërim në të gjitha ndërrimet dhe Njësitë Punuese të Kompanisë.

Për regjistrimin e bizneseve të reja në kontabilitetin e Kompanisë, si dhe evidentimin e bizneseve të cilat nuk i zhvillojnë aktivitetet e tyre biznesore, Komisionet e formuara vazhdojnë t'i përmbushin detyrat e veta me sukses duke përcjellë gjendjen faktike në terren për të tri Njësitë Punuese. Si rezultat i kësaj rrjedh se **91** biznese në Mitrovicë, **41** biznese në Vushtrri dhe **29** biznese në Skenderaj që në total i bie **161** biznese janë vendosë në pasivë. Në këtë periudhë në Mitrovicë janë regjistruar **103** biznese të reja, në Vushtrri **62** biznese të reja dhe në Skenderaj **18** biznese të reja, që në total i bie **183**.

Të gjitha bizneset qofshin ato të mëdha, të mesme apo edhe biznese të vogla, të cilat iu kanë ikur obligimeve të pagesave kundrejt Kompanisë, kam angazhuar dhe mobilizuar inkasantët e të tri Njësitë Punuese që fillimisht të identifikojnë borxhlinjtë e mëdhenj dhe të përgatiten lëndët për të cilat pastaj janë dorëzuar tek përmbaruesi privat.

Nga janari 2022 deri më 31.12.2022 në procedurë tek përmbaruesi privat janë proceduar **730** lëndë.

Në këtë periudhë raportuese, jemi përballur me lëndë të vjetra të vitit **2005, 2006** dhe **2007**, të cilat janë kthyer në ri procedurë në vitin **2012/2013**, edhe pse në ri-procedurë palët kanë shfrytëzuar ligjin për faljen e borxheve publike, ligj ky i cili ka përfshirë borxhet deri në fund të vitit **2008**. Andaj, duke pas parasysh bazën ligjore dhe vjetërsinë e lëndëve në mënyrë që t'i ikim shpenzimeve procedurale, si dhe duke e ditur se ndjekja e tyre ka humbur efektin juridiko-ligjor, kjo për shkak të neglizhencës nga ana e gjykatës e cila këto lëndë i ka lënë pas dore duke shkaktuar vjetërsimin e tyre, kam vendosë që të tërhiqemi nga këto lëndë.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A, Mitrovice

Për mbikëqyrjen e punëve nga afër në sektorin operativ, kam marrë vendim që të gjithë Kryepunëtorët e ekipeve përkatëse, gjatë gjithë kohës të jenë së bashku me ekipet e tyre në terren, gjë që do të mundësojë evidentimin dhe eliminimin e parregullsive të cilat mund të shfaqen gjatë përmbushjes së detyrave të punës në këtë sektor.

Përmbushja e punëve dhe detyrave operative në kohë pandemie është e rëndësishë së veçantë pasi që është punuar me kapacitet të plotë duke mos lënë anash as eliminimet e deponive ilegale si në Lagjen e populluar me komunitetet RAE, në rrugën "Fadil Deliqi" (ish fabrika e duhanit), në rrugën "Driton M. Veliu", si dhe deponi tjera ilegale sipas kërkesës së organit mbikëqyrës komunal, pastrimin e lumit Trepça etj.

Defektet e automjeteve/kamionëve kanë qenë pengesë e përmbushjes së detyrave ditore në mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave, kjo për faktin se automjetet të cilat i posedon Kompania janë të stërvjetruara dhe të amortizuara. Megjithatë, sanimi i menjëhershëm i defekteve ka ndikuar që përmbushja e detyrave në grumbullim të mbeturinave të arrijë nivelin e kënaqshëm dhe pa ankesa nga qytetarët, e gjithë kjo punë është kryer fal angazhimit maksimal të punëtorisë mekanike e cila ka punuar edhe ditëve të vikendit.

Ofrimi i shërbimit në grumbullim të mbeturinave në komunën e Mitrovicës bëhet për rreth **98%** të ekonomive familjare edhe në komunën e Vushtrrisë shërbimi bëhet rreth **98%**, derisa për komunën e Skenderajt shërbimi bëhet rreth **77.68%** të ekonomive familjare.

**Tabela 1 paraqet sasinë e grumbullimit të mbeturinave të ndara sipas njësive**

Sasia e Grumbullimit të Mbeturinave Sipas Njësive 2021 - 2022			
Viti	2021	2022	%
Mitrovicë	21,646.03	25,995.71	20.09
Vushtrri	20,046.22	18,954.10	-5.44
Skënderaj	7,464.06	7,908.27	5.95

**Tabela 2 paraqet sasinë e grumbullimit të mbeturinave në regjion**

Sasia e Grumbullimit të Mbeturinave në Regjion 2021 - 2022		
2021	2022	%
49,033.06 Ton	52,858	7.8



**Tabela 3 paraqet numrin e zbrazjeve të kamionëve në deponi**

Numri i Zbrazjeve të Kamionëve në Deponi			
Viti	2021	2022	%
Mitrovicë	6117	7.167	17.16
Vushtrri	4251	3.767	-11.38
Skenderaj	1661	1.743	4.93
<b>Totali:</b>	<b>12,031</b>	<b>12,677</b>	<b>5.37</b>

**Tabela 4 paraqet shpenzimet e derivateve të naftës**

Derivatet e Shpenzuara për Njësi			
Viti	2021	2022	%
Mitrovicë	114,085.49 litra	116.794.21	2.37
Vushtrri	122,720 litra	119.855.56	-2.33
Skënderaj	73,162.5 litra	73.085.25	-0.10


Tek shpenzimet e derivateve të specifikuar në Njësinë Punuese në Mitrovicë, janë të përfshira edhe shpenzimet e administratës qendrore.

